



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 8/2 Prot

Tiranë, më 27.02.2020

V E N D I M

Nr.29, datë 27.02.2020

**MBI VERIFIKIMIN E LIGJSHMËRISË SË MARRËDHËNIES SË PUNËSIMIT
TË PUNONJËSES SË BASHKISË LEZHË, *****.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të procedurës së verifikimit,

VËREJ SE:

Me anën e kërkesës së regjistruar me nr. 8 prot., datë 7.1.2020, punonjësja ***** aktualisht me detyrë, “Specialiste e Transportit dhe Infrastrukturës”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, pranë Bashkisë Lezhë, ka ngritur pretendimin se ka fituar statusin e nëpunësit civil që prej vitit 2009, pas kryerjes së procesit të konkurrimit, në pozicionin “Specialist”, në Këshillin e Qarkut, Lezhë dhe ka vazhduar marrëdhënien e punës në këtë institucion deri në datën 31.12.2015, kur i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkak të shkurtimit të pozicionit të punës pas ristrukturimit të institucionit.

Më tej, punonjësja informon se marrëdhëniet e punësimit në shërbimin civil, kanë vazhduar në Bashkinë Lezhë, ku është emëruar në pozicionin, “Specialiste në Sektorin e Hartimit të Projekteve dhe Monitorimit të Investimeve”, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, pranë kësaj bashkie dhe më pas, ka kaluar në pozicionin, “Specialiste e Transportit dhe Infrastrukturës”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, ku vazhdon punon edhe aktualisht.

Sipas saj, emërimi në pozicionin “Specialist në Sektorin e Hartimit të Projekteve dhe Monitorimit të Investimeve”, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, pranë Bashkisë Lezhë, është kryer në zbatim të një vendimi gjyqësor me lëvizje paralele nga lista e pritjes prandaj,

konkluzioni i nxjerrë në vendimin paralajmërues nr. 203, datë 9.10.2017 dhe vendimin nr.93, datë 15.10.2019, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, se emërimi i saj në Bashki është bërë në kundërshtim me ligjin, nuk është i drejtë.

Për verifikimin e pretendimit të mësipërm, u rishqyrtua Raporti Përfundimtar i Mbikëqyrjes së kryer pranë Bashkisë Lezhë, i cili ka përfunduar me vendimin paralajmërues nr. 203, datë 9.10.2017, të Komisionerit, si dhe dokumentacioni shkresor i administruar gjatë inspektimit tematik të kryer në këtë njësi të qeverisjes vendore, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, i cili ka përfunduar me vendimi nr. 93, datë 15.10.2019, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Nga përmbajtja e tyre rezultoi se pas verifikimit të dokumentacionit të administruar në dosjen e personelit, është arritur në përfundimin se emërimi i punonjësës ***** në pozicionin, “*Specialiste në Sektorin e Hartimit të Projekteve dhe Monitorimit të Investimeve*”, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, pranë Bashkisë Lezhë, me aktin nr.375, datë 1.8.2016, të Kryetarit të Bashkisë, e më pas, kalimi në pozicionin, “*Specialiste e Transportit dhe Infrastrukturës*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, pranë kësaj bashkie, me aktin nr. 576, datë 1.11.2016, po të Kryetarit të Bashkisë, është kryer pa respektuar procedurën e përcaktuar në legjislacionin e shërbimit civil dhe për pasojë përbëjnë veprime administrative absolutisht të pavlefshme.

Ky konkluzion dhe rendi i veprimeve që duhen kryer për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë, janë shprehur në dispozitivin e vendimit paralajmërues nr. 203, datë 9.10.2017, si dhe vendimit nr. 93, datë 15.10.2019, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Ndërkohë, pasi është njohur me vendimet e mësipërme të Komisionerit, punonjësja ***** ka ngritur pretendimin se konkluzioni që punësimi i saj është i paligjshëm, nuk është i drejtë pasi ajo është nëpunëse civile e konfirmuar dhe emërimi i saj është realizuar me lëvizje paralele nga lista e pritjes (*pas risrstrukturimit të Këshillit të Qarkut Lezhë*) në zbatim të vendimit nr. 595, datë 16.9.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Shkodër.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ka kërkuar edhe një herë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Lezhë, të dërgojë gjithë dokumentacionin e nevojshëm që disponon në lidhje me këtë rast.

Nga ana e institucionit, janë dërguar kopje të vendimit nr. 595(516), datë 16.9.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe vendimit nr. 2924, datë 13.7.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, që kanë zgjidhur rastin e lirimit nga shërbimi civil të nëpunëses në fjalë, pas risrstrukturimit të Këshillit të Qarkut Lezhë.

Nga përmbajtja e këtyre vendimeve rezulton se, punonjësja ***** , ka qenë nëpunëse civile, në pozicionin “*Specialiste e Statistikave dhe Investimeve*”, në Këshillin e Qarkut, Lezhë, që prej vitit 2009, detyrë të cilën e ka kryer deri në datën 31.12.2015, kur me Urdhrin nr. 122, datë 31.12.2015, i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare me këtë institucion, për shkak të shkurtimeve të vendit të punës, pas ristrukturimit të institucionit.

Ligjshmëria e këtij akti është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, në respektim të nenit 50, pika 7, shkronja “ç” dhe pika 8, e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, ka vendosur detyrimin e institucionit Këshilli i Qarkut, Lezhë, të dëmshpërblejë punonjësen sipas vjetërsisë në shërbimin civil me 9 paga mujore dhe regjistrimin e saj në listë pritjeje, deri në 2 vjet. Ky vendim ka marrë formë të prerë duke u kthyer në titull ekzekutiv, me vendimin nr. 2924, datë 13.7.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë.

Duke analizuar vendimin e mësipërm arrihet në konkluzionin se gjykata, pavarësisht përdorimit të shprehjes “*regjistrimin në listën e pritjes deri në dy vjet*” e ka fjalën për mundësinë që njeh pika 8, e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, sipas së cilës nëpunësit civilë, të cilët janë larguar nga shërbimi civil, si pasojë e ristrukturimit apo mbylljes së institucionit, brenda periudhës 2 vjeçare pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, (në këtë rast që prej datës 13.7.2018, që është data kur vendimi nr. 595, datë 16.9.2016, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Shkodër është kthyer në titull ekzekutiv, me vendimin nr. 2924, datë 13.7.2018, të Gjykatës së Apelit, Tiranë), kanë të drejtë që, kur shpallet një pozicion i lirë, duke luajtur rol aktiv, të kërkojnë të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji, etj.

Por, referuar akteve të emërimit dhe mënyrës së punësimit të punonjëses ***** , në pozicione të ndryshme të shërbimit civil në Bashkinë Lezhë, rezulton se ato veprime administrative nuk janë kryer në përputhje me procedurën e përcaktuar në dispozitën e sipërcituar e për rrjedhojë, megjithëse punësimi është bërë në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, brenda periudhës dy vjeçare që parashikon pika 8, e nenit 50, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në asnjë prej rasteve të emërimit, për shkak të mosrespektimit të procedurës së konkurrimit, nuk janë krijuar marrëdhënie të rregullta në shërbimin civil.

Por, pavarësisht sa më sipër, duhet nënvizuar se për punonjësen ***** , brenda periudhës 2 vjeçare (e cila ka filluar prej datës 13.07.2018), në ato raste kur mund të shpallen pozicione të lira në shërbimin civil, për të cilat ajo plotëson kërkesat e veçanta, nuk ka pengesë për të marrë pjesë në konkurrim si nëpunëse civile për procedurat e lëvizjes paralele

apo ngritjes në detyrë, sipas përcaktimeve të nenit 25 dhe 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA

1. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore në Bashkinë Lezhë, për të rregulluar gjëndjen e ligjshmërisë, të veprjës sipas masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit nr. 93, datë 15.10.2019, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të aktit nr. 576, datë 1.11.2016, të nxjerrë nga Kryetari i Bashkisë, për emërimin e punonjësës *****, në pozicionin, “Specialiste e Transportit dhe Infrastrukturës”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, pranë Bashkisë Lezhë.
2. Të shpallë të lirë pozicionin e punës, “Specialist i Transportit dhe Infrastrukturës”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe të marrë masat për plotësimin e tij sipas procedurave konkurruese të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.
3. Punonjësja ***** , brenda periudhës 2 vjeçare, (e cila ka filluar prej datës 13.07.2018), ka të drejtë të konkurrojë si nëpunëse civile për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas përcaktimeve të nenit 25 dhe 26, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
4. Të njoftohen për këtë vendim, Bashkia Lezhë, njësia e burimeve njerëzore të kësaj bashkie dhe punonjësja, *****.
5. Për kryerjen e detyrave të përcaktuara më sipër, institucionit i lihet afat, **10** ditë, nga momenti i komunikimit të këtij vendimi.
6. Me kalimin e këtij afati, duhet të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mënyrën e zbatimit të vendimit.

7. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjositjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha